



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10 Maj 2023

Nr: 480

Ora: 13:30

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMEVE NR. 210 ID, 237 ID, 238 ID, 239 ID, 240 ID, 241 ID, 242 ID, 280 ID, 281 ID TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA DHE NR. 256 ID I DEPUTETIT Z. FLAMUR NOKA, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 10 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
Z. Flamur Noka, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

SUBJEKT: Z. Nuri Belba, Kryetar i Bashkisë Prrenjas;
Z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan;
Z. Arif Tafani, Kryetar i Bashkisë Belsh;
Zj. Majlinda Bufi, Kryetar i Bashkisë Roskovec;
Zj. Eriselda Sefa, Kryetar i Bashkisë Lushnje;
Koordinatori i Partisë Socialiste të Shqipërisë, Njësia 8;
Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore, Tiranë.

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Data: 10 Maj 2023

Nr: 490

Ora: 13:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 210, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 280, 281, 256 ID, për shkelje administrative”

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, ka depozituar denoncimet regjistruar me numër 210 ID, 237 ID, 238 ID, 239 ID, 240 ID, 241 ID, 242 ID, 280 ID, 281 ID si dhe deputeti z. Flamur Noka, ka depozituar denoncimin regjistruar me nr. 256 ID, për të cilat pretendohet se ka patur shkelje administrative të parashikimeve ligjore.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indiceve/denoncimeve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se janë kryer shkelje administrative.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljevetë pretenduara.

Institucionet e denoncuara janë si më poshtë vijon:

Data: 10 Maj 2023 Nr: 480
Ora: 13:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 210, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 280, 281, 256 ID, për shkelje administrative”

1- **Denoncim i regjistruar me nr. 281 ID, ndaj Bashkisë Prrenjas, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:**

- **Denoncimi nr. 281 ID, "Në datën 5 Prill 2023, Bashkia Prrenjas ka postuar në faqen e vet në Facebook:**

"Asfaltimi i rrugës së #Rashtanin, investim nga fondi i bashkisë Prrenjas, një premtim i mbajtur duke u ardhur në ndihmë të banorëve të zonës"

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan z. Damian Gjknuri:

"Me Njerëzit për Njerëzit- Rehabilitimi i plotë i rrugës në fshatin Rashtan është një tjetër shembull i punëve të mira që Kryetari Nuri Belba po kryen në Prrenjas.

Gjatë bashkëbisedimit me banorët e kësaj zone mësova se rruga kishte qenë një kërkesë e kahershme e tyre.

I garantova se me Nuren në krye të punëve edhe për katër vite të tjera si edhe mbështetjen e pakursyer të qeverisë do vijojmë t'u qëndrojmë pranë për të zgjidhur problematikat e tyre.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga bashkia Prrenjas.

Në njoftimin e bërë deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrës janë: z. Damian Gjknuri-Deputet i Qarkut, z. Nuri Belba-Kryetar i Bashkisë, banorë të zones.

Përpos prezencës së z. Gjknuri në postimet e bëra vërehet përdorimi i sloganeve elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021.

Theksohet se në faqen zyrtare në Facebook të bashkisë Prrenjas dhe kryetari të saj, si dhe Drejtuesit Politik të Qarkut Elbasan z. Gjknuri gjenden disa postime të aktiviteteve të Bashkisë Prrenjas, në të cilat ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan".

Më datë 12.4.2023, bashkisë Prrenjas i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, dhe institucioni në vijim informon se "Më datë 5.4.2023, bashkia Prrenjas ka zhvilluar një veprimtari publike që lidhet me asfaltimin e rrugës në fshatin Rashtan, bashkia Prrenjas, të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 31.3.2023 në përputhje me nenin 92, pika 3 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, ku është paralajmëruar edhe pjesëmarrja në të e z. Damian Gjknuri, deputet i Qarkut Elbasan. Veprimtaria në fjalë ka qenë e hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikut.

Gjatë inspektimit të punimeve kryetari i Bashkisë ka shpjeguar se:

"Kjo është rrugë e fshatit Rashtan. Ka qenë një pjesë shumë e hershme e banorëve. Fillon këtu dhe mbaron tek qendra e fshatit dhe mbaron tek shkolla. Është një rrugë që do t'i japë një zhvillim zonës për arsye se Rashtani është një fshat i cili ka një zonë të zhvilluar. Kohët e fundit

ka filluar të marrë shumë zhvillim vreshtaria...kjo rrugë do të lidhe edhe fshatin Teravec. Gjithashtu kjo rrugë do i japë zgjidhje kanaleve vaditëse dhe pjesës së ndricimit...do jenë përfitues edhe dy lagjet e tjera. Besoj që me të njëjtin ritëm ne do vazhdojmë të punojmë...këto janë investime që ne kemi mundur t'i bëjmë me buxhetin e bashkisë...besoj se me këtë trend do të vazhdojmë edhe 4 vjeçarin e ardhshëm pasi mendojmë dhe synojmë që brenda 4 vjeçarit do lidhim të gjithë fshatrat e bashkisë.”

Sikurse mund të konstatohet, nga përmbajtja e fjalës së kryetarit të bashkisë nuk rezulton të këtë bërë premtime elektorale dhe në asnjë rast nuk ka përmendur fushatën dhe garën zgjedhore ndërmjet subjekteve. Ai thjeshtë ka bërë një përshkrim të përfitimeve të anës funksionale që ka rruga në fjalë. Më pas deputeti i qarkut Elbasan z. Gjikhuri ka mbajtur fjalën e tij. Bashkia e ka pasqyruar aktivitetin në faqen zyrtare si një veprimtari publike të saj. Deri në kohën e marrjes së emailit në datën 5.4.2023 bashkia nuk ka informacion se veprimtaria e raportuar me pjesëmarrësit në fjalë të jetë konsideruar nga K.Q.Z si veprimtari e ndaluar sipas nenit 92, pika 4 e Kodit Zgjedhor, i ndryshuar.

Sa më sipër, për sa kohë vetë kryetari i bashkisë, në veprimtarinë publike të organizuar e të raportuar rregullisht nga bashkia Përrenjas, nuk ka bërë fushatë zgjedhore gjatë inspektimit të punimeve të asfaltimit të rrugës së fshatit Rashtan, vlerësojmë se asnjë burim publik në adminstrimin e kësaj bashkise nuk konsiderohet si përdorim në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Kryetari i bashkisë Prrrenjas z. Nuri Belba në asnjë rast nuk ka mbajtur fjalën e tij si një person politik dhe as që ka patur qëllim për ta përdorur veprimtarinë për qëllime zgjedhore.

Ftesa për pjesëmarrje e deputetit të qarkut Elbasan, të Z. Gjikhuri, dhe raportimi rregullisht pranë K.Q.Z për këtë pjesëmarrje, është bërë pasi ai është deputet i këtij qarku dhe ftesa për të për të marrë pjesë në inspektimet e punëve publike të zonës së tij elektorale është tërësisht legjitime dhe e justifikuar. Theksojmë se Bashkia nuk mund të bëhet përgjegjëse për shkakun se Z. Gjikhuri, në cilësinë e drejtuesit Politik të qarkut Elbasan e ka përdorur ose jo veprimtarinë publike për qëllime të fushatës elektorale sikurse pretendohet në denoncimin në fjalë.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Prrrenjas.

Për sa më sipër, në mbështetje të fakteve të administruara rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj kryetarit të bashkisë Prrrenjas, është objekt shqyrtimi i vendimit nr. 411, më datë 25.4.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 220 ID, 221 ID, 282 ID, 320 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, për shkelje për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në këto kushte të ndodhur përpara një denoncimi të gjykuar më parë (res iudicata) vlerësohet se duhet pushuar çështja objekt shqyrtimi i denoncimit nr. 281 ID.

2- Denoncim i regjistruar me nr. 210 ID ndaj bashkisë Belsh/kryetarit të bashkisë Belsh z. Arif Tafani, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 210 ID, "Kryetari i Bashkisë Belsh ka postuar në faqen e vet në "Belsh-Bashkëbisedim me fermerët, për krijimin e Grupit Vendor të Veprimit, që duke u bërë bashkë u krijohet mundësia për të marrë më shumë financim.**

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Elbasan, Deputeti, z. Damian Gjijnuri:

"Në Belsh-Ku bashkë me Arifin dhe ekspertin e fushës Ermal Elezi zhvilluam një bashkëbisedim me fermerë, pronarë të bujtinave e sipërmarrës në fushën e agro-turizmit për iniciativën e krijimit të Grupit Vendor të Veprimit në zonën e Dumresë. Aplikimi i kësaj skeme, e njohur edhe në vendet e Bashkimit Europian me të cilët kemi përafruar edhe legjislacionin shqiptar, do sjellë bashkëpunimin e aktorëve të zonës duke fuqizuar më tej dy sektorë të rëndësishëm për Belshin, agro-turizmin dhe bujqësinë.

Kjo nënkupton edhe më shumë financim nga Bashkimi Europian sikurse është edhe aplikimi i programit "IPARD". #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë#SkaKohëPërPushim Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Belsh. Në njoftim nuk lajmërohet prezenca e Drejtuesit Politik të Qarkut Elbasan z. Damian Gjijnuri."

Më datë 20.4.2023, bashkisë Belsh i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, por institucioni nuk i është përgjigjur kërkesës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Belsh.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me nr. **210 ID** rezultoi se:

Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, aktiviti i bashkisë Belsh është konsideruar i lejuara për t'u zhvilluar, në kuptim të nenit 3, të vendimit, nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral.

Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Të ndodhur 2 (dy) muaj përpara zgjedhjeve, konkretisht në një periudhë strikte të monitorimit të gjithë aktorëve politikë dhe drejtuesit e organeve publike duhet të tregojnë kujdes të shtuar në përdorimin e fjalimeve me përmbajtje elektorale, në takimet e organizuara në përmbushje të funksioneve të tyre.

Nga verifikimi i të gjithë provave dhe fakteve si dhe materialit filmik rezulton se gjatë fjalës së deputetit z. Gjikhuri është vërejtur përdorimi i thënieve me natyrë tërësisht elektorale në takim, si dhe thirrje për mbështetje duke ë bërë aktivitetin jo më institucional, por elektorale. Përdorimi i aktiviteteve të organizuar nga një organ publik, për të kryer thirrje elektorale duke kërkuar mbështetje për subjektin zgjedhor në garë, përbën përdorim të burimeve publike në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, për qëllime zgjedhore.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*

Përsa më sipër, kryetari i bashkisë Belsh, ka lejuar përdorimin e një aktiviteti institucional, për kryerjen e thirrjeve elektorale, duke përdorur burime publike të organit që ai drejton, duke shkelur kështu detyrimet që përcakton neni 91 i Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, *dënohet me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.*

Pas vlerësimit në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstatoj se z. Arif Tafani ka shkelur dispozitat e pikës 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

3- Denoncimet e regjistruara me nr 237 ID dhe 280 ID ndaj Bashkisë Roskovec/Kryetarit të bashkisë Roskovec zj. Majlinda Bufi, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 237 ID, "Në datën 28 Mars 2023, Bashkia Roskovec ka postuar në faqen e vet në Facebook:**
“#Marinëz Vijon puna për rikualifikimin urban të qendrës së Marinzës e cila përfshin; Sistemim trotuaresh; Ndriçim; Lulishte; Ambiente argëtuese për të rritur e fëmijë; Aktualisht ka përfunduar investimi i pjesës nëntokësore si; Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të

zeza; Sistemi i furnizimit me ujë; Puna jonë do të vazhdojë; #BashkiaRoskovec #SkaKohëPërPushim #eGjithëVëmendjaPërJu ”

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier z. Taulant Balla: “RoskovecVijon puna për rikualifikimin urban të qendrës së Marinzes. Premtim i mbajtur #ShqipëriaEArdhmjaJonë #TëBashkuarJoTëNdarë”

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Roskovec. Në njoftimin e bërë nuk deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrës do të ishte edhe Z. Taulant Balla. Përpos prezencës së Z. Balla në postimet e bëra vërehet përdorimi i sloganeve elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021.

Theksohet se në faqen zyrtare në “Facebook” të bashkisë Roskovec, si dhe drejtuesit politik të Qarkut Fier z. Balla gjenden disa postime të aktiviteve të bashkisë Roskovec, në të cilat ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier”.

- **Denoncimi nr. 280 ID**, “Në datën 4 prill 2023, Bashkia Roskovec ka postuar në faqen e vet në Facebook: “Roskovec-Vijon puna për rikonstruksionin total të shkollës “Didin Bishani” në #Kurjan. Ndërhyrja për rehabilitimin e kësaj shkolle po kryhet me fonde të Bashkimit European”. Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier z. Taulant Balla: “Roskovec, Vijon puna për rikonstruksionin total të shkollës “Didin Bishani” në #Kurjan. Ndërhyrja për rehabilitimin e kësaj shkolle po kryhet me fonde të Bashkimit European Roskovec Vijon puna për rikonstruksionin total të shkollës “Didin Bishani” në #Kurjan. Ndërhyrja për rehabilitimin e kësaj shkolle po kryhet me fonde të Bashkimit European”

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Roskovec. Në njoftimin e bërë nuk deklarohet paraprakisht nga bashkia se pjesëmarrës do të ishte edhe z. Taulant Balla. Përpos prezencës së z. Balla në postimet e bëra vërehet përdorimi i sloganeve elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021.

Lidhur me denoncimin nr. **237 ID**, më datë 3.4.2023, bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe institucioni bën me dije se “Ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e aktiviteve në KQZ në datën 13.3.2023, ku citohet se ky aktivitet është i hapur për publikun. Për më tepër, duke mos pasur konfirmim të pjesëmarrësve si edhe duke qenë një aktivitet i hapur, edhe pjesëmarrja ka qenë me përfaqesues të bashkisë Roskovec dhe të tjerë (të tjerë pasi nuk kishim të konfirmuar pjesëmarrjen, psh punonjës të firmes zbatuese, apo deputetit z. Taulant Balla).”

Ky aktivitet nuk është aspak politik, por është në kuadër të mbarëvajtjes dhe kontrollit të fillimit të punimeve në këtë objekt, si pjesë e përditshme e procesit të punës së kryetarit të bashkisë. Ky aktivitet është raportuar brenda afatit ligjor duke respektuar afatin 5 ditor.”

Lidhur me denoncimin nr. **280 ID**, më datë 11.4.2023, bashkisë Roskovec i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe institucioni bën me dije se *“Në kuadër të programit të punës së kryetares së bashkisë, është përfshirë inspektimi i punimeve në objektin "Inspektim puunimesh në shkollën Kurjan (Rikonstruksion me fonde të BE-së)". Ky aktivitet është raportuar në ndërfaqen e aktiviteteve në KQZ në datën 31.3.2023, ku citohet se ky aktivitet është i hapur për publikun. Për më tepër, duke mos pasur konfirmim të pjesëmarrësve si edhe duke qenë një aktivitet i hapur, edhe pjesëmarrja ka qenë me përfaqësues të bashkisë Roskovec dhe të tjerë (të tjerë pasi nuk kishim të konfirmuar pjesëmarrjen, p.sh punonjës të firmës zbatuese, apo deputetit z. Taulant Balla). Ky aktivitet nuk është aspak politik, por është në kuadër të mbarëvajtjes dhe kontrollit të fillimit të punimeve në këtë objekt, si pjesë e përditshme e procesit të punës së kryetarit të bashkisë. Ky aktivitet është raportuar brenda afatit ligjor duke respektuar afatin 5 ditor.”*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 25.4.2023 dhe 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga palët.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me **nr. 237 ID dhe 280 ID** rezultoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se pjesëmarrja e z. Balla në këto takime lidhet me detyrat funksionale të deputetit. Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektorale. Fjalimet me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Nga kqyrja e materialeve video rezultoi se në këto takime nuk evidentohen thirrje elektorale apo fjalime politike, nga pjesëmarrësit z. Balla apo kryetari i bashkisë zj. Majlinda Bufi.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, **nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”***

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara nuk u arrit të provohet se në këtë takim ka pasur thirrje elektorale apo thirrje për të votuar kandidatin në zgjedhje. U vlerësua se bashka Roskovec ka përmbushur detyrimin për raportim, sipas parashikimeve të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Në këto kushte vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për arsye se rasti objekt shqyrtimi nuk përmban bazë të mjaftueshme për të konstatuar shkeljen e nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator

4- Denoncim i regjistruar me nr. 238 ID ndaj Bashkisë Lushnje/Kryetarit të bashkisë Lushnje zj. Eriselda Sefa, për 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncimi nr. 238 ID** "Në datën 28 Mars 2023, Kryetarja e Bashkisë Lushnje ka postuar në faqen e vet në Facebook:

"Propaganda e punës"!

*Çdo punë në #Lushnjë, qytet e Njësi është përgjigja më e mirë kundrejt "baltës" politike! Ecim përpara me mbajtjen e çdo angazhimi para qytetarëve sikurse është edhe nisja e punës për veshjen e fasadave të pallateve në lagjen "Loni Dhamo"!
#BashkëPërLushnjën"*

Një postim lidhur me këtë aktivitet ka bërë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier z. Taulant Balla: "Lushnje Nisja e punës për rikonstruksionin e fasadave të pallateve në bllokun e banimit të lagjes "Loni Dhamo" duke zbatuar edhe teknologjitë për efikasitetin e energjisë elektrike është një tjetër dëshmi e projekteve transformuese në këtë Bashki. Premtim i mbajtur #punëjollafe #ShqiriaEardhmjaJonë"

Zhvillimi i këtij takimi është raportuar në ndërfaqen e KQZ nga Bashkia Lushnje.

Në njoftimin e bërë deklarohet paraprakisht nga Bashkia se pjesëmarrës janë: Taulant Balla, Eriselda Sefa, FSHZH.

Përpos prezencës së z. Balla në postimet e bëra vërehet përdorimi i sloganeve elektorale të Partisë Socialiste për Zgjedhjet Parlamentare 2021.

Theksohet se në faqen zyrtare në Facebook të Kryetares së Bashkisë Lushnje, si dhe Drejtuesit Politik të Qarkut Fier z. Balla gjenden disa postime të aktiviteteve të Bashkisë Lushnje, në të cilat ka marrë pjesë edhe Drejtuesi Politik i Qarkut Fier".

Më datë 3.4.2023, bashkisë Lushnje i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike dhe institucioni bën me dije se "Termet e përdorura janë vendosur në thonjëza, që nënkupton një reagim publik të bërë kundrejt punëve publike që kryen institucioni i Bashkisë Lushnje në përmbushjen e detyrave të tij. Nuk është përmenduar asgjë politike dhe nuk është përfshirë asnjë parti politike apo slogan. Është një reagim publik në cilësinë e kryebashkiakes në faqen e saj personale për të përgenjeshtuar akuzat e bëra kundrejt punëve publike të çdo dite drejtuar institucionit që ajo drejton.

Aktiviteti është raportuar brenda afateve ligjore link-u: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/18/inspektim-per-fillimin-e-punimeve-per-rikualifikimin-e-fasadave-te-pallateve-ne-bllokun-e-banimit-ne-lagjen-loni-dhamo/> dhe nuk është aktivitet i ndaluar.”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me **nr. 238 ID** rezultoi se:

Nga verifikimi i dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se pjesëmarrja e z. Balla në këtë takim lidhet me detyrat funksionale të deputetit. Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektoral. Fjalimi me përmbajtte elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Nga kqyrja e materialeve video rezultoi se në këtë takime nuk evidentohen thirrje elektorale apo fjalime politike, nga pjesëmarrësit z. Balla apo kryetari i bashkisë zj. Eriselda Sefa.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor “*Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.*”

Të ndodhur në kushtet që veprimtaria e mësipërme nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, vlerësoj se nuk ndodhemi para shkelljeve të parashikimeve ligjore të nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për bashkinë Lushnje/Kryetarin e bashkisë Lushnje zj. Eriselda Sefa.

5- Denoncimet e regjistruara me nr. 239, 240, 241, 242 ID ndaj Bashkisë Elbasan, për 4 (katër) veprimtari publike, për të cilat pretendohet si vijon:

- **Denoncim nr. 239 ID, “Më datë 23.3.2023, bashkia Elbasan ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 16.03.2023.**

Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri, si dhe Ministrija e Arsimit dhe Sportit znj. Evis Kushi.

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Elbasan:

"#ElbasaniSkaKohëPërPushim

**rrugët "Theofan Popa", "Koço Brisku", "Ndriçim Duraku", "Ibrahim Berania"*

Gjithashtu foto të këtij aktiviteti janë postuar edhe në faqen zyrtare të z. Gjicknuri, me këtë përmbajtje:

"Me Gledin dhe Evisin në Elbasan ku inspektuam nga afër punimet që po kryhen për rehabilitimin e plotë të rrugëve në Lagjen "Haxhias" dhe "5 Maji".

Këto investime janë një tjetër shembull i qasjes së kryetarit të bashkisë që pas ndërhyrjeve në qendër të qytetit po shtrihet edhe në lagjet periferike.

Vëmendja jonë do vijojë të jetë e shtuar edhe në katër vitet e ardhshme me Gledin në krye të punëve. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Ndërsa video e postuar mbi këtë aktivitet, sërish në faqen në Facebook-ut të z. Gjicknuri ka këtë përmbajtje:

"Elbasan Vijoje punimet për rehabilitimin e plotë të rrugëve "Ndriçim Duraku", "Koço Brisku" dhe "Ibrahim Berania" në lagjen "5 Maji".

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Foto të aktivitetit janë postuar edhe në faqen e Facebook të Ministres së Arsimit dhe Sportit znj. Kushi:

"Premtim i mbajtur. Tashmë ka nisur puna për rikonstruksionin e plotë të rrugëve "Theofan Popa", "Koço Brisku", "Ndriçim Duraku" dhe "Ibrahim Berania" në Elbasan. Rreth 2500 banorë të lagjeve "Haxhias" dhe "5 Maji" janë përfitues të drejtpërdrejtë të këtyre investimeve.

Duke qenë zona informale me nevoja të shumta në infrastrukturë, Bashkia e Elbasanit ka ndërhyrë fillimisht në sistemimin e kanalizimeve dhe tashmë i erdhi radha ndërtimit të rrugës. Më vjen mirë që banorët i rrisin kërkesat me besimin se së bashku me Gledin do të vijoje punën me përkushtimin maksimal për përmbushjen e nevojave të tyre.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim"

Aktiviteti është pasqyruar gjerësisht edhe në media. Disa nga mediat që e kanë transmetuar aktivitetin dhe kanë përcjellë mesazhet e transmetuara janë:

Koha Jonë <https://kohajone.com/kryebashkiaku-i-elbasanit-llatja-po-mbajme-premtimet-duke-normalizuar-zonat-informale/>

TV Skampa <https://www.youtube.com/ëatch?v=2uBg6YO8mKI>

Elbasanineës.tv <https://elbasanineës.tv/llatja-po-mbajme-premtimet-duke-normalizuar-zonat-informale-ne-formale/>

Ky aktivitet "Inspektim i punimeve" i organizuar nga Bashkia Elbasan është përdorur haptas dhe qartas për të kryer diskutime elektorale dhe kryer premtime të drejtpërdrejta në emër të

maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit. Jo vetëm kaq, por komentet e kryera nga z. Gjikhuri i lidhin drejtpërdrejt investimet pas zgjedhjeve për bashkinë me zgjedhjen sërish të Kryebashkiakut aktual.

Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjikhuri: “(...) Unë them se ky e ka bërë mirë këtë punë katër vitet e kaluara. Jam i bindur që do marrë prapë mbështetjen e qytetarëve të Elbasanit sepse ky do të bëjë dy fish më shumë. Ja u garantoj që punët e nisura nuk do përfundojnë me kaq. Se këtë ndaj e ka përzgjedh Edi Rama, ta ketë mëkëmbësin e tij në kuptimin politik të fjalës në bashki, me qëllim që projektet e nisura të vazhdojnë. Unë nga ana tjetër ju them një gjë që ne jemi modeli i punëve, bëjmë dhe gabime nuk jemi perfekt, kemi edhe ne të meta, ama nuk merremi me llafet e politikës së madhe, Elbasani bunker, si krahu tjetër që e do thjesht për trofe politik Elbasanin se s’ka asnjë projekt. Ne na duhet që këto punë të nisura të vazhdojnë dhe të kemi edhe qeverinë e Edi Ramës nga mbrapa që Elbasani të ndryshojë në çdo cep të tij. Unë ju uroj suksese.” Fjalimi i plotë në këtë link <https://ëëë.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/228518593031964/>

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të Bashkisë Elbasan në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe paralajmërohet pjesëmarrja në të, e z. Damian Gjikhuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan, deputete, Prefekti i Qarkut Elbasan, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Administratori i Njësisë nr.5 dhe Administratori NjA nr.6"

- **Denoncim nr. 240 ID,** “Më datë 21.3.2023, bashkia Elbasan ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 16. 3.2023.

Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri, si dhe deputetja e Partisë Socialiste znj. Desantila Tahiraj.

Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë Elbasan:

“Fillon rehabilitimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Coha, fshati Gjonme, Njësia Administrative Gjergjan. Një rrugë që do tu shërbej të gjithë banorëve të zonës duke rritur kështu cilësinë e jetës dhe zhvillimin. Investimet po vazhdojnë në lagjet e brendshme të fshatrave dhe nuk do të ndalen, po punohet si në qytet ashtu edhe në fshat me ritme të larta dhe kështu do të vazhdojë pa u ndalur. Fokusi ynë është te puna, jo te llafet e te zhurma e atyre që vetëm shfryjnë e bërtasin dhe kujtohen të flasin tani pas një gjumi të gjatë. Elbasani është i njerëzve që punojnë e sakrifikojnë çdo ditë, jo i prapambetjes dhe interesave personale të atyre që duan të shfrytëzojnë punën e njerëzve për politikën e ditës.

#ElbasaniNukNdalet”

“Bashkë me Gledin dhe Dasantilën inspektuam nga afër ecurinë e punimeve për rehabilitimin e plotë të rrugës në fshatin Gjonmë, Njësia Administrative Gjergjan.

Gjatë bashkëbisedimit me banorët mësova se rruga, që përfshin sistemimin, shtrimin me asfalt dhe pajisjen me ndriçim, ka qenë një kërkesë e kahershme e tyre. Këtë shqetësim ata e kishin ngritur edhe gjatë takimeve me kryetarin Gledian Llatja dhe stafin e bashkisë në ndalesat për buxhetimin me pjesëmarrje, një praktikë që i jep zë çdo qytetari të ngrerë problematikat e zonës ku banon. I garantova banorët se ky investim nuk është i fundit, bashkia me në krye Gledin, do vijojë të ketë vëmendje të shtuar për zonat rurale në katër vitet e ardhshme. Qytetarët e Elbasanit janë njerëz të punës, e duan zhvillimin dhe nuk pranojnë të keqpërdoren nga ata që kanë për qëllim zgjidhjen e halleve të tyre personale dhe jo vizionin për një të ardhme edhe më të mirë.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArthemjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Ndërsa video e postuar mbi këtë aktivitet, sërish në faqen në Facebook-ut të z. Gjijnuri, ka këtë përmbajtje:

“Elbasan Ku ditën e djeshme pamë nga afër punimet që po kryhen për rehabilitimin e plotë të rrugës në fshatin Gjonmë, Njësia Administrative Gjergjan. Elbasan, ku ditën e djeshme pamë nga afër punimet që po kryhen për rehabilitimin e plotë të rrugës në fshatin Gjonmë, Njësia Administrative Gjergjan. Rruga ka qenë një kërkesë e kahershme e banorëve të cilët e kishin ngritur shqetësimin edhe gjatë bashkëbisedimeve që kryetari i palodhur i bashkisë Gledian Llatja ka zhvilluar për buxhetimin me pjesëmarrje, një praktikë që i jep zë çdo qytetari të ngrerë shqetësimet e zonës ku banon.”

Foto të aktivitetit janë postuar edhe në faqen e Facebook të deputetes znj. Tahiraj, me këtë përmbajtje:

“Në Elbasan Ku ditën e djeshme pamë nga afër punimet që po kryhen për rehabilitimin plotë të rrugës në fshatin Gjonmë, Njësia Administrative Gjergjan. Rruga ka qenë një kërkesë e kahershme e banorëve të cilët e kishin ngritur shqetësimin edhe gjatë bashkëbisedimeve që kryetari i palodhur i bashkisë Gledian Llatja ka zhvilluar për buxhetimin me pjesëmarrje, një praktikë që i jep zë çdo qytetari të ngrerë shqetësimet e zonës ku banon. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArthemjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Aktiviteti është pasqyruar gjerësisht edhe në media. Disa nga mediat që e kanë transmetuar aktivitetin dhe kanë përcjellë mesazhet e transmetuara janë:

Koha Jonë <https://kohajone.com/gjijnuri-dhe-llatja-elbasani-nuk-eshte-foltore-e-sali-berishes-por-e-investimeve-te-barabarta-si-per-qytetin-dhe-per-fshatin/>

Vizion Plus <https://www.vizionplus.tv/gjijnuri-inspekton-punimet-ne-elbasan-ky-qytet-nuk-eshte-foltore-e-sali-berishes-por-i-gjerave-te-medha/>

Lexo.al <https://www.lexo.al/2023/03/gjijnuri-dhe-llatja-elbasani-nuk-eshte-foltore-e-sali-berishes-por-e-investimeve-te-barabarta-si-per-qytetin-dhe-per-fshatin/>

Elbasanineës.tv <https://elbasaniplus.com/vazhdojne-me-ritme-intensive-investimet-ne-laqjet-e-medha-llatja-kemi-detyrime-ndaj-qtetareve-ge-na-besuan/21/>

Ky aktivitet “Inspektim i punimeve” i organizuar nga bashkia Elbasan është përdorur haptas dhe qartaz për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit.

Jo vetëm kaq, por komentet e kryera nga z. Gjikhuri i lidhin drejtpërdrejt investimet pas zgjedhjeve për bashkinë me zgjedhjen sërish të Kryebashkiakut aktual. Ky përbën, minimalisht, një tjetër element të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë, specifikisht përdorimi i fuqisë së qeverisjes qendrore, pasi narrativa e përdorur lë të kuptohet se, nëse qytetarët nuk votojnë për Kryebashkiakun aktual, investimet nuk do të vijojnë.

Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjikhuri: “(...) Qytetarët e Elbasanit e kanë kuptuar që këtu ka një investim të përditshëm, ka një kujdes nga kryetari i bashkisë, por mbi të gjitha Gledi nuk është vetë, ai është përfaqësuesi i Edi Ramës. Ne nuk e ndryshojmë dot Elbasanin pa pasur mbështetjen e qeverisë. Ne nuk duam ta kemi Elbasanin bunker politik i Sali Berishës. Sepse mëkëmbësi i tij do ta kthejë Elbasanin në foltore të Sali Berishës. Elbasani nuk është për foltore, Elbasani ka qenë foltore për arsimin, për gjëra të mëdha, por nuk është për beteja politike të Sali Berishës. Oferta jonë nëpërmjet Gledit është çdo vit ndërhyrje në çdo cep të bashkisë së Elbasanit, qoftë në qytet edhe në fshat për ta ndryshuar infrastrukturën e zonës (...)”

Fjalimi i plotë në këtë link

<https://www.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/1150545745624781/>

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të bashkisë Elbasan në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe paralajmërohet pjesëmarrja në të, e z. Damian Gjikhuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan, deputetë”.

- **Denoncim nr. 241 ID,** “Më datë 24.3.2023, bashkia Elbasan ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 16.3.2023.

Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe drejtuesi politik i Qarkut Elbasan, deputet i Qarkut Vlorë dhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste z. Damian Gjikhuri, si dhe deputeti i Partisë Socialiste z. Luan Duzha. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Elbasan:

“#ElbasaniSkaKohëPërPushim

Më Damianin dhe Luanin në Kusarth të Bradasheshit ku po mbajmë fjalën e dhënë për banorët e asaj zone. #ElbasaniNukNdalet”

Data: 10 Maj 2023 Nr: 480
Ora: 13:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 210, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 280, 281, 256 ID, për shkelje administrative”

Gjithashtu foto të këtij aktiviteti janë postuar edhe në faqen në Facebook të z. Gjikhuri: “Elbasan Njësia Administrative Bradashesh.

Me Gledin dhe deputetin Luan Duzha pamë nga afër ecurinë e punimeve që po kryhen për rehabilitimin e rrugës në fshatin Kusarth. Faza e parë e punimeve ka përfunduar dhe së shpejti rruga e pajisur me ndriçim dhe asfalt do të jetë gati në shërbim të banorëve. Shumë është bërë për Elbasanin megjithatë kemi ende punë për të bërë ndaj me Gledin në krye të bashkisë dhe mbështetjen e pakursyer të qeverisë do vijojmë edhe për katër vite të tjera zbatimin e projekteve transformuese që mes të tjerash përmirësojnë jetesën e qytetarëve.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEardhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Ndërsa video e postuar mbi këtë aktivitet, sërish në faqen në Facebook-ut të z. Gjikhuri, ka këtë përmbajtje: “Elbasan Në Njësinë Administrative Bradashesh, ku vijojnë punimet për rehabilitimin e plotë të rrugës në fshatin Kusarth.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEardhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Aktiviteti është **pasqyruar gjerësisht edhe në media**. Disa nga mediat që e kanë transmetuar aktivitetin dhe kanë përcjellë mesazhet e transmetuara janë:

Koha Jonë <https://kohajone.com/kryebashkiaku-llatja-urbanizimi-edhe-ne-fshatra-me-gellim-permiresimin-e-jeteses-se-banoreve/>

Vizion Plus <https://www.vizionplus.tv/gjikhuri-dhe-llatja-inspektojne-investimin-e-ri-ne-elbasan-mbeshtetje-per-te-shtrire-investimet-ne-qjithe-elbasanin/>

Lexo.al <https://www.lexo.al/2023/03/gjikhuri-dhe-llatja-inspektojne-investimin-e-ri-ne-elbasan-mbeshtetje-per-te-shtrire-investimet-ne-qjithe-elbasanin/>

Elbasanineës.tv <https://elbasanineës.tv/gjikhuri-dhe-llatja-inspektojne-investimin-e-ri-ne-elbasan-mbeshtetje-per-te-shtrire-investimet-ne-qjithe-elbasanin/>

Ky aktivitet “Inspektim i punimeve” i organizuar nga bashkia Elbasan është përdorur haptas dhe qartas për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 majit.

Jo vetëm kaq, por komentet e kryera nga z. Gjikhuri i lidhin investimet pas zgjedhjeve për bashkinë me zgjedhjen sërish të kryebashkiakut aktual. Ky përbën, minimalisht, një tjetër element të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë, specifikisht përdorimin e fuqisë së qeverisjes qendrore, pasi narrativa e përdorur lë të kuptohet se, nëse qytetarët nuk votojnë për Kryebashkiakun aktual, investimet nuk do të vijojnë.

Drejtuesi politik i PS për Qarkun Elbasan z. Damian Gjikhuri: “(...) Kandidati i bashkisë nuk është vetëm, por ka ekip, ka qeverinë, ka projekte, ka vizion për Elbasanin. Prandaj unë

mendoj dhe shpresoj që njerëzit të na japin mbështetjen për të vazhduar punën për të mirat e Elbasanit. Njerëzit ikin e vijnë, e rëndësishme është puna të mbetet. Nëpërmjet punës që po bën kryetari i bashkisë, bashkë me gjithë ekipin, me deputetin, të gjithë siç jemi t'i shtyjme përpara të gjitha këto punë sepse kemi dhe mbështetjen e qeverisë, po dhe Gledi vetë është shumë i futur bashkë me administratorin, ka bërë dëgjesat e lagjeve, ka marrë shënim çfarë duhet, ka vënë një prioritet. Këtë vit do bëjmë këto, vitin tjetër diçka tjetër, dhe kjo është garancia. Krahu tjetër ka vetëm një moto: si të sjellim revolucionin e foltores nga Tirana në Elbasan. Elbasanllinjët s'para i kanë qejf këto. Elbasanllinjët duan jetën e qetë, nuk duan betejat politike, nuk duan këto luftërat e Tiranës. Duan të përmirësojnë jetën e tyre, ta bëjnë Elbasanin e bukur. Dhe unë them kjo është qasja që ne kemi, ky është premtimi jonë për Elbasanllinjët.”

Fjalimi i plotë në këtë

link <https://www.facebook.com/Gjikhuri.Damian/videos/468330265426295/>

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të bashkisë Elbasan në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe paralajmërohet pjesëmarrjen në të, e z. Damian Gjikhuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan, deputetë, Prefekti i Qarkut Elbasan, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Administratori i Njesisë Administrative”.

- **Denoncim nr. 242 ID**, “Më datë 25.3.2023, bashkia Elbasan ka zhvilluar një veprimtari publike të cilën e ka njoftuar paraprakisht në ndërfaqen e KQZ-së, në datën 16.3.2023.

Në këtë aktivitet përpos kryetarit të Bashkisë Elbasan ka marrë pjesë edhe Deputetja e Qarkut Elbasan znj. Desantila Tahiraj. Njoftimi për zhvillimin e kësaj veprimtarie publike është postuar në faqen zyrtare të kryetarit të bashkisë Elbasan:

“Shushicë - Rruga “Riza Salla”, rrugë e cila i shërben shkollës së fshatit Hajdaran dhe gjithë banorëve të zonë, po i japim zgjidhje përfundimtare një problemi shumëvjeçar dhe kështu do të vazhdojmë në të gjithë Elbasanin #ElbasaniNukNdalet”.

Gjithashtu video e këtij aktiviteti është postuar edhe në faqen në Facebook të z. Gjikhuri, drejtues politik i Partisë Socialiste në Qarkun Elbasan:

“Shushicë - Rruga “Riza Salla” është një tjetër investim i bashkisë së Elbasanit që do i shërbejë shkollës së fshatit Hajdaran dhe gjithë banorëve të zonës.

#TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaeArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”

Aktiviteti është pasqyruar gjerësisht edhe në media. Disa nga mediat që e kanë transmetuar aktivitetin dhe kanë përcjellë mesazhet e transmetuara janë:

Koha Jonë <https://kohajone.com/nje-tjeter-rruge-ne-hajdaran-te-shushices-nje-tjeter-premtim-i-mbajtur-nga-gledian/>

Lexo.al <https://www.lexo.al/2023/03/gjikhuri-dhe-llatja-inspektojne-investimin-e-ri-ne-elbasan-mbeshtetje-per-te-shtrire-investimet-ne-qithe-elbasanin/>

Ky aktivitet “Inspektim i punimeve” i organizuar nga bashkia Elbasan është përdorur haptas dhe qartaz për të kryer diskutime elektorale dhe hedhur premtime të drejtpërdrejta në emër të maxhorancës në funksion të zgjedhjeve të 14 Majit.

Jo vetëm kaq, por komentet e kryera nga z. Gjijnuri i lidhin investimet pas zgjedhjeve për bashkinë me zgjedhjen sërish të Kryebashkiakut aktual. Ky përbën, minimalisht, një tjetër element të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë, specifikisht përdorimin e fuqisë së qeverisjes qendrore, pasi narrativa e përdorur lë të kuptohet se, nëse qytetarët nuk votojnë për kryebashkiakun aktual, investimet nuk do të vijojnë.

Kryetari i bashkisë Elbasan Z. Gledian Llatja: “(...) Kemi treguar se jemi vetëm për punë, ne dimë të bëjmë vetëm punë, jo si të tjerët që dinë të bëjnë vetëm llafe, ne këtë kemi dashur dhe këtë po bëjmë, t’i qëndrojmë afër qytetarëve dhe banorëve në qytet, në fshat, në zonat periferike, edhe në zonat më të thella, pikërisht për këtë. Qëllimi ynë është që të kemi një bashkëpunim midis strukturave vendore dhe qytetarëve ashtu si e kemi pasur deri tani, me besimin për të vazhduar punë, pasi qytetarët kanë halle, ndaj ne duam punë. Ne nuk kemi as hallet e Sali Berishës as të Ilir Metës, ata t’i dalin vetë për Zot halleve të veta, ne jemi për hallet e popullit. Ne për këtë jemi, jemi të gjithë bashkë, nuk jemi vetëm, kemi edhe mbështetjen e madhe të qeverisë, ashtu edhe siç shihet po bëhen edhe pritrat lumor në lumin Shkumbin, të cilat nuk shkaktojnë më përmytje, janë investime të mëdha që na ka mbështetur qeveria. Në mënyrë aktive filluam të bëjmë punë në të mirë të komunitetit, pasi ne këtë dimë të bëjmë të mirë menaxhojmë të administrojmë. (...) Këto investime është e vërtetë që duhet të ishin bërë para 30 vitesh, dhe ne po i bëjmë, ndërsa opozita nuk ka bërë asgjë. Katër vite kur ishin në pushtet asnjëherë nuk u kujtuan për Hajdaranin, as për Shushicën, as për rrugët, ndërsa tani thonë nuk është bërë kjo rrugë, këtë se bën Zoti, ne po e bëjmë, dhe po punojmë çdo ditë. Nuk është e moralshme të dalësh para një fushate dhe të thuash se kjo rrugë nuk është bërë”

Fjalimi i plotë në këtë link

<https://www.facebook.com/ljatja.gledian/videos/170754715845513/>

Deputetja e Qarkut Elbasan Znj. Desantila Tahiraj: “... Sigurisht kemi edhe shumë punë të tjera për të bërë, dhe qoftë Gledi qoftë ne si përfaqësues të Partisë Socialiste, kemi dhe ndjejmë përgjegjshmërinë e vazhdimin të këtyre punëve, pikërisht për këtë e kërkojmë votën dhe mbështetjen tuaj në 14 maj, për të vazhduar punë, për të vazhduar shtrimin e gjithë rrugëve si kjo rrugë që po bëhet sot. Për të vazhduar për të bërë kopshte më të mira, çerdhe më të mira, shkolla më të mira dhe infrastrukturë më të mirë publike për të gjithë qytetarët. Siç e shikoni në nuk vijmë vetëm kur vijnë zgjedhjet siç mund të vijë dikush tjetër. (...) Gledi në këtë rrugëtim nuk është vetëm. Përfaqëson partinë Socialiste, përfaqëson Edi Ramën. Ne jemi një

ekip, një ekip politik bashkë më njerëzit me në krye Damian Gjicknurin, i cili ka edhe prejardhje nga zona juaj, dhe pa dyshim është një zë i fortë sot që ne flasim, është numri 2 i Partisë Socialiste dhe ka treguar që i mban premtimet dhe di ti mbështesë projektet zhvillimore të zonës. Dhe kemi fatin që Gledi ka bërë goxha projekte, projekte që janë në ndihmë të komunitetit dhe jo projekte për shoë”.

Vlen të theksohet se nga konsultimi i raportimit të Bashkisë Elbasan në ndërfaqe për këtë aktivitet, rezulton se aktiviteti është publik, i hapur për pjesëmarrjen e medias dhe publikun, si dhe paralajmërohet pjesëmarrja në të e z. Damian Gjicknuri, udhëheqës politik i Qarkut Elbasan, deputetë, Prefekti i Qarkut Elbasan, Kryetari i Këshillit të Qarkut, Administratori i Njësisë Administrative Shushicë”.

Më datë 3.4.2023, bashkisë Elbasan i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e marra, objekt shqyrtimi regjistruar me nr. **239 ID, 240 ID, 241 ID, 242 ID**, nëpërmjet adresës elektronike dhe institucioni bën me dije se, “Referuar denoncimit nga KRIIK për aktivitetet të Bashkisë Elbasan më datë 21.3.2023, 23.3.2023, 24.3.2023, ju sqarojmë se në fjalën e kryetarit të Bashkisë nuk ka thirrje politike, diskutime elektorale apo premtime në funksion të zgjedhjeve të 14 Majit. Kryetari i Bashkisë ka zhvilluar bashkëbisedim me qytetarët duke shpalosur vizionin e bashkisë Elbasan, nevojat e komunitetit dhe zgjidhjet e mundshme që ofron bashkia.

Lidhur me pjesëmarrjen e drejtuesit politik dhe deputetes se qarkut Elbasan në këtë takim theksojmë se vjen për shkak të funksionit politik dhe fjala e tyre i përmbahet këtij formati.

Nga ana e Bashkisë Elbasan ky aktivitet është raportuar në kohë duke listuar dhe personat pjesëmarrës.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Elbasan.

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar të dhënave të deklaruara në ndërfaqen e raportimeve, aktivitetet e bashkisë Elbasan janë konsideruar të lejuara për t’u zhvilluar, në kuptim të nenit 3, të vendimit, nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Pjesëmarrja e deputetit të zonës apo e funksionarëve politike jo domosdoshmërisht e kthen aktivitetin e një institucioni publik, në një aktivitet elektorale. Fjalimi me përmbajtje elektorale, logot, materialet propagandistike dhe çdo element tjetër, që mbart mesazhe elektorale, janë elementë që e kthejnë aktivitetin në të tillë. Të ndodhur 2 (dy) muaj përpara zgjedhjeve, konkretisht në një periudhë strikte të monitorimit të gjithë aktorëve politikë dhe drejtuesit e organeve publike duhet të tregojnë kujdes të shtuar në përdorimin e fjalimeve me përmbajtje elektorale, në takimet e organizuara në përmbushje të funksioneve të tyre.

Nga verifikimi i të gjithë provave dhe fakteve si dhe materialit filmik rezulton se gjatë fjalës së deputetëve z. Gjyknuri apo zj. Tahiraj, si dhe kryetarit të bashkisë z. Llatja janë vërejtur përdorimi i thënieve me natyrë tërësisht elektorale në takim, duke i bërë aktivitet jo më institucionale, por elektorale. Përdorimi i aktiviteteve të organizuar nga një organ publik, për të kryer thirrje elektorale duke kërkuar mbështetje për subjektin zgjedhor në garë, përbën përdorim të burimeve publike në kuptim të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, për qëllime zgjedhore.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*

Përsa më sipër, kryetari i bashkisë Elbasan, ka lejuar përdorimin e një aktiviteti publik, për kryerjen e thirrjeve elektorale, ka përdorur burime publike të institucionit që ai drejton, duke shkelur kështu detyrimet që përcakton neni 91, i Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, *dënohet me gjobë nga 3 000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi ka vlerësuar në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, konstaton se z. Gledian Llatja ka shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor.*

6- Denoncimi i regjistruar me nr. 256 ID, ndaj Koordinatorës së “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, Njësia 8 dhe z. Blendi Nallbani, për 1 (një) veprimtari publike, objekt i denoncimeve të ardhur nga deputeti z. Flamur Noka, për të cilën pretendohet si vijon:

- **Denoncim nr. 256 ID, “Në datën 30.03.2023, në faqen elektronike faktor_al është publikuar një video ku paraqitet ish portieri i Partizanit Bledi Nallbani së bashku me koordinatoren e PS duke bërë fushatë në shkollat e njësisë nr. 8 në Tiranë, takim i mbajtur me nxënësit e shkollës, veprim ky që tregon qartazi përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të nxënësve dhe stafit akademik brenda orarit të mësimit duke kryer veprimtari dhe aktivitete për qëllime zgjedhore, në kundërshtim neni 3, pika 1.3/c dhe neni 6, pika 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator”**

Bashkëlidhur po ju nisim traskriptimin e videos:

Z. Blendi Nallbani "Faleminderit... faleminderit që keni ardhur.

Sic jeni në dijeni sot bëjmë hapjen e aktivitetit që e organizon njësia numër 8, Partia Socialiste. Kemi dhe shefen të deleguar, që e kemi në zonën tonë, që është senatorja kryesore e këtij aktiviteti. Ju urojmë suksese, është aktivitet i gjatë. Kush është më i forti, le të fitojë. Për gjëra

të tjera nuk kam çfarë të them më. Dua qetësi, dua rregull. Kjo është për të mirën e komunitetit, kjo është për të mirën e sportit, me që kemi dhe ditën e sportit që ka organizuar, bashkia Tiranë, edhe qyteti jonë... Dalshim faqebardhë, suksese, me të fortët, më të mirët."

Më datë 7.4.2023 Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimin e marrë, nëpërmjet adresës elektronike, por institucioni nuk i është përgjigjur kërkesës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimet e regjistruara me nr. **256 ID**, rezultoi se:

Pas shqyrtimit të provave dhe materialit filmik, nuk u arrit të provohej se ka pasur thirrje elektorale. Gjithashtu, subjektet pjesëmarrëse në këtë video, dalin jashtë sferës rregulluese të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, për të vijuar më tej hetimin administrativ.

Përsa më sipër, në mungesë të informacionit të nevojshëm, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ, pasi nuk ka të dhëna të plota për konstatimin e shkeljes të dispozitave të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92, 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
 - a) z. Gledjan Llatja, kryetar i bashkisë Elbasan, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
 - b) z. Arif Tafani, kryetar bashkisë Belsh, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e hetimit administrativ ndaj:
 - a) z. Nuri Belba, kryetar i bashkisë Prrenjas;
 - b) zj. Majlinda Bufi, kryetar i bashkisë Roskovec;
 - c) zj. Eriselda Sefa, kryetar i bashkisë Lushnje;

- d) Koordinatorit të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Njësia 8;
 - e) Drejtorit të Zyrës Vendore Arsimore, Tiranë.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI